




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 21.10.2024 DERI MË 25.10.2024


NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave	NRP-02-4872-2024
2.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të fermerëve në thirrjen "Përkrahja e fermerëve me serra"	NRP-02-4873-2024
3.	Vendim	NRP-02-4881-2024
4.	Vendim	NRP-02-4887-2024
5.	Vendim	NRP-02-4889-2024
6.	Vendim për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve	NRP-02-4890-2024
7.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-02-4893-2024
8.	Vendim	NRP-02-4894-2024



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

- Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit - ritenderim”, me Nr. prokurimi: 623-24-10243-2-2-1 dhe me Nr. të brendshëm: 623-24-051-2-2-1, të datës 21.10.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues;
 - 1.2. Vjollca Berisha, anëtare;
 - 1.3. Enise Dina, anëtare.
- Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Shërbime konsulente individuale për nevojat e Komunës së Rahovecit - ritenderim”, me Nr. prokurimi: 623-24-10243-2-2-1 dhe me Nr. të brendshëm: 623-24-051-2-2-1, të datës 21.10.2024.
- Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
- Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4873 Nr. i faq./Br.str/No.pg 191

Data/Datum/Date 21 / 10 / 24

RAHOVEC / GRAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të fermerëve për thirrjen “Përkrahja e fermerëve me serra”

1. **Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të fermerëve në kuadër të thirrjes “Përkrahja e fermerëve me serra”, me Nr. Prot. 2987, të datës 17.9.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1. Egzon Thaqi, kryesues;
 - 1.2. Bahrije Çmega, anëtare;
 - 1.3. Flutura Beqiri, anëtare.
2. Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e ankesave të fermerëve për thirrjen për aplikim “Përkrahja e fermerëve me serra” me Nr. 2987, të datës 17.9.2024.
3. Obligohet komisioni që këto punë t’i kryejë duke u bazuar në legjislacionin aktual në fuqi.
4. Komisioni do të filloj punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
5. Obligohet komisioni që, pas përfundimit të punëve, të hartojë raport me shkrim për kryetarin e Komunës dhe për Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- DBPZhR-së, dhe
- Arkivit.

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Komisioni Komunal për Riintegrim, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 44, nënparagrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 2 dhe 6, neni 47, paragrafi 1, nënparagrafi 1.11, andaj u vendos si në dispozitiv të Rregullores të QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, mbështetur në vendimin e kryetarit të Komunës së Rahovecit, nr. 271 të datës 14.07.2014, për themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, në harmoni me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr:

V E N D I M

1. REFUZOHET kërkesa e [REDAKTUAR] e riatdhesuara nga Gjermania, me dhunë, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegrit për vazhdim të akomodimit, nr. 3177, e datës 08/10/2024, të parashtruar në ZKKK në Komunën e Rahovecit.

A r s y e t i m

Komisioni Komunal për Riintegrim, në seancën e mbajtur më datë 17.10.2024, ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar më 08.10.2024 nga [REDAKTUAR] nga Komuna e Rahovecit, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegrit për akomodim me qira, duke u bazuar në rekomandimet e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe rregulloren në fuqi.

Në rastin e [REDAKTUAR] e cila ka përfutur mbështetje për akomodim më shumë se 3 herë, duke iu referuar Rregullores QRK nr. 22/2020, të **nenit 33 – “Akomodimi me qira mund të vazhdohet pas 12 muajve vetëm për personat e cënueshëm, dhe kjo vlerësohet e domosdoshme nga organet kompetente”**. Sipas vlerësimeve të anëtarëve të komisionit, bazuar në rregulloren në fuqi, [REDAKTUAR] nuk klasifikohet më si person i cënueshëm, dhe fëmijët e saj kanë arritur moshën madhore.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur në afat prej 30 (tridhjet) ditësh pas pranimi të tij, mund të paraqes ankesë në Komisionin e Ankesave.

Rahovec, më 23.10.2024.


Vendimi u dërgohet:

1. [REDAKTUAR]
2. Koordinatorit Rajonal të MPB-së,
3. Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, dhe
4. Arkivit të Komunës.


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*), neneve 74 dhe 92 të paragrafit 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, nr.1005, i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 të paragrafit 4 dhe nenit 21 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me nr.1427, të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDACTED] përfaqësues ligjor i OJQ-së për personat me aftësi të kufizuara HANDIKOS – Rahovec, me nr. protokoli 3036, e dt. 23.09.2024, për ndihmë financiare prej 950.00€ (nëntëqind e pesëdhjetë euro) për mbulimin e shpenzimeve për organizimin e projektit për rehabilitimin fizio dhe psikoterapeutik të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
2. Mjetet do të sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

OJQ për personat me aftësi të kufizuara HANDIKOS në Rahovec është organizatë joqeveritare, e cila merret me rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara të moshave të ndryshme, e në veçanti me fëmijët me aftësi të kufizuara në Komunën e Rahovecit.

Në këtë drejtim, OJQ HANDIKOS në Rahovec, ka hartuar projektin për për rehabilitimin fizio dhe psikoterapeutik të fëmijëve me aftësi të kufizuara, i cili projekt do t'i shërbejë personave me aftësi të kufizuara për përmirësimin e jetës, përmes intervenimeve rehabilituese, risocializimit dhe integrimin e tyre në shoqëri.

Andaj, me qëllim të përkrahjes së kësaj shoqate në këtë projekt, është e domosdoshme ndihma financiare për përfundimin e këtij projekti mjaft domethënës për këta persona, që janë pjesë e shoqërisë sonë.

Duke marrë parasysh atë që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi u dërgohet:

- OJQ HANDIKOS në Rahovec,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E ORAHOVAC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY ORAHOVAC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4889 Nr. i faq./Br.str./No.pg 192
Data/Datum/Date 25 /10 /24
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 të paragrafit 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, nr.1005, i datës 29.03.2017, dhe nenit 4 të paragrafit 4 dhe nenit 22 të paragrafit 1 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, me nr.1427, të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [REDAKTUAR] të dt. 24.10.2024, për ndihmë financiare prej 1,000.00€ (njëmijë euro) për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për angazhimin e saj në basketboll, e cila aktualisht luan për klubin “Villeneuve d’Ascq” në qytetin e Lille, në Francë.
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Zyrës së Kryetarit, dhe do të transferohen në xhirollogari të babait, [REDAKTUAR]
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

[REDAKTUAR] ka parashtruar kërkesë me datë 24.10.2024, me numër të protokollit 3351, për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për angazhimin e saj në basketboll, e cila aktualisht luan për klubin “Villeneuve d’Ascq” në qytetin e Lille, në Francë.

[REDAKTUAR] është një sportiste e talentuar, e cila me përkushtimin dhe angazhimin e saj ka arritur të përfaqësojë vendin tonë me dinjitet në arenën ndërkombëtare.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- [REDAKTUAR]
- *Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe*
- *Arkivi.*

Smajl Latifi
Kryetar i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 4890 Nr. i faq/Br.str/No.pg 192
Data/Datum/Date 25/10/24

RAHOVEC/ОРАХОВАЦ

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe 92 të paragrafit 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, nr. 1005, i datës 29.03.2017, thirrjes publike për aplikim me nr. prot. 3182, të datës 08.10.2024, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve

- Caktohet** komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve sipas thirrjes publike për aplikim “Përkrahja e bizneseve START-UP në Komunën e Rahovecit” me nr. prot. 3182, të datës 08.10.2024, në këtë përbërje:
 - 1.1 Fidan Hoti, kryesues;
 - 1.2 Saranda Shala, anëtar;
 - 1.3 Veton Mustafa, anëtar;
 - 1.4 Izet Morina, anëtar;
 - 1.5 Almedina Jaha, anëtare nga shoqëria civile.
- Komisioni ka për detyrë që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të projekt-propozimeve të bizneseve në Komunën e Rahovecit, sipas thirrjes publike për aplikim “Përkrahja e bizneseve START-UP në Komunën e Rahovecit”, të shpallur nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, me nr. prot. 5764, të datës 17.10.2023.
- Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në thirrjen publike për aplikim të shpallur nga Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, me nr. prot. 3182 të datës 08.10.2024.
- Komisioni do të fillojë punën menjëherë dhe ka mandat deri në përfundimin e procedurës së shpalljes së përfituesve.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
- Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor (Kabineti i Kryetarit të Komunës)



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/ 4869/24, e datës 21.10.2024 për qasje në dokumente publike nga Bekim Salihu-Instituti GAP dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, dhe atë:
 - 1.1. Vlera e mjeteve të ekzekutuara në tri vitet e fundit (përfshirë edhe këtë vit) të mjeteve financiare nga kontrata kolektive.
 - 1.2. Shuma e mjeteve që janë ende në procedurë gjyqësore apo përmbarimore dhe që pretendohet apo rrezikohet të merren nga komuna në periudhën e ardhshme.
2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/ 4869/24, e datës 21.10.2024 për qasje në dokumente publike nga Bekim Salihu nga Instituti GAP, për qasje në dokumente publike. Pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtit i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë në: Vlerën e mjeteve të ekzekutuara në tri vitet e fundit (përfshirë edhe këtë vit) të mjeteve financiare nga kontrata kolektive dhe shumën e mjeteve që janë ende në procedurë gjyqësore apo përmbarimore dhe që pretendohet apo rrezikohet të merren nga komuna në periudhën e ardhshme.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimi të tij.

Vendimi u dërgohet:

- **Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP,**
- **Bekim Salihu nga Instituti GAP, dhe**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT / KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 4894 Nr. i faq./Br.str/No.pg 193

Data/Datum/Date 25 / 10 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për punët shtesë dhe punë të paparapara e Menaxherit të Projektit dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, me nr. prot.3362, e datës: 25.10.2024 dhe kërkesës së Operatorit Ekonomik “Age Group” Sh.P.K, me nr. prot.3362, të datës: 25.10.2024, në projektin “**Ndërtimi i shtandeve (tezgave) mobile për mbajtjen e panairëve**”, me nr. të prokurimit 623-24-3589-5-2-1, në shumën prej 1,980.00€ (një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë euro e zero cent).
2. Ky vendim merret pasi që është konstatuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe menaxheri i kontratës së projektit dhe verifikimit të gjendjes në terren, se projekti është në fazën përfundimtare dhe për t’u funksionalizuar është e nevojshme që të kryhen punë shtesë.
3. Obligohet Sektori i Prokurimit që t’i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Prokurimit,
- Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Menaxherit të Projektit,
- Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, dhe
- Arkivit.

